

VENDIM
Nr. 675, datë 29.7.2015

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 375, DATË 6.6.2012, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR KRIJIMIN, REGJISTRIMIN, MËNYRËN E FUNKSIONIMIT,
TË ADMINISTRIMIT E TË NDËRVEPRIMIT DHE PËR SIGURINË E SISTEMIT TË
REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME (ALBSReP)”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 33/2012, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, dhe të nenit 4, të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”, me propozimin e ministrit të Drejtësisë dhe ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në pikën 6, të vendimit nr. 375, datë 6.6.2012, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa:

1. Pas nënndarjes “ii”, të shkronjës “b”, shtohet nënndarja “iii”, me këtë përmbajtje:
“iii. Qendra e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara.”.
2. Pas nënndarjes “ii”, të shkronjës “c”, shtohet nënndarja “ii/1”, me këtë përmbajtje:
“ii/1) Qendra e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama